



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2022:099203
Datë: 05.07.2024
Numri i dokumentit: 05901029

C.nr.298/2022

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Betim Behluli, në çështjen juridike kontestimore të paditësve B.E-C, B.K, B.N, B.E dhe B.M te gjithë nga Rahoveci të cilët i përfaqëson avokat D.M nga Prizreni, sipas autorizimit në shkresat e lëndës, kundër të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale për Arsim, të cilën e përfaqëson avokat B.O nga Rahoveci, sipas autorizimit në shkresat e lëndës, për shkak të kompensimit nga marrëdhënia e punës per inflacion, , jashtë seancës, me datë 05.07.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

I.APROVOHET PJESËRISHT SI E BAZUAR kërkesëpadia e paditëses paditësve B.E-C, B.K, B.N, B.E dhe B.M të gjithë nga Rahoveci.

II.DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëses B.E-C në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit t'ia paguaj dhe atë: për periudhën kohore Qershor – Dhjetor 2019 në shumën prej 74.35 euro, për periudhën kohore Janar – Dhjetor 2020 në shumën prej 11.01 euro, për periudhën kohore Janar – Dhjetor 2021 në shumën prej 187.60 euro, për periudhën kohore Janar – Nentor 2022 në shumën prej 638.92 euro, e në shumën e përgjithshme prej **911.88 euro**, të gjitha me kamatë ligjore 8% nga data 16.05.2022 (data e praqitjes se padisë) e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarimit të detyrueshëm”.

-DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëses B.K në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit t'ia paguaj dhe atë: për periudhën kohore Qershor – Dhjetor 2019 në shumën prej 74.35 euro, për periudhën kohore Janar – Dhjetor 2020 në shumën prej 11.01 euro, për periudhën kohore Janar – Dhjetor 2021 në shumën prej 187.60 euro, për periudhën kohore Janar – Nentor 2022 në shumën prej 638.92 euro, e në shumën e përgjithshme prej **911.88 euro**, të gjitha me kamatë ligjore 8% nga data 16.05.2022 (data e praqitjes se padisë) e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarimit të detyrueshëm”.

-DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëses B.N në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit t'ia paguaj dhe atë: për periudhën kohore Qershor – Dhjetor 2019 në shumën prej 74.35 euro, për periudhën kohore Janar – Dhjetor 2020 në shumën prej 11.01 euro, për periudhën kohore Janar – Dhjetor 2021 në shumën prej 187.60 euro, për periudhën kohore Janar – Nentor 2022 në shumën prej 638.92 euro, e në shumën e përgjithshme prej **911.88 euro**, të gjitha me kamatë ligjore 8% nga data 16.05.2022 (data e praqitjes se padisë) e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarimit të detyrueshëm”.

-DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit B.E në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit t'ia paguaj dhe atë: për periudhën kohore Qershor – Dhjetor 2019 në shumën prej 74.35 euro, për periudhën kohore Janar – Dhjetor 2020 në shumën prej 11.01 euro, për periudhën kohore Janar – Dhjetor 2021 në shumën prej 187.60 euro, për periudhën kohore Janar – Nentor 2022 në shumën prej 638.92 euro, e në shumën e përgjithshme prej **911.88 euro**, të gjitha me kamatë ligjore 8% nga data 16.05.2022 (data e praqitjes se padisë) e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarimit të detyrueshëm”.

-DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit B.M në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit t'ia paguaj dhe atë: për periudhën kohore Qershor – Dhjetor 2019 në shumën prej 74.35 euro, për periudhën kohore Janar – Dhjetor 2020 në shumën prej 11.01 euro, për periudhën kohore Janar – Dhjetor 2021 në shumën prej 187.60 euro, për periudhën kohore Janar – Nentor 2022 në shumën prej 638.92 euro, e në shumën e përgjithshme prej **911.88 euro**, të gjitha me kamatë ligjore 8% nga data 16.05.2022 (data e praqitjes se padisë) e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarimit të detyrueshëm”.

III. REFUZOHET SI E PABAZUAR pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditëseve B.E-C, B.K, B.N, B.E dhe B.M të gjithë nga Rahoveci, mbi shumën aprovuar si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

IV. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që në emër të shpenzimeve të procedurës të autorizuarit të paditëses të i paguajë shumën prej 665.00 euro, në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësit B.E-C, B.K, B.N, B.E dhe B.M të gjithë nga Rahoveci, përmes përfaqësuesit të tyre të autorizuar, më datën 16.05.2022 në këtë gjykatë ndaj të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, kanë parashtruar padinë për shkak të kompensimit nga marrëdhënia e punës per inflacion.

Të njëjtit sipas padisë kanë theksuar se janë në marrëdhënie pune tek e paditura në SH.M.L “Xhelal Hajda-Toni” në Rahovec. Paditësit kanë precizuar kërkesëpadinë, sipas së cilës ka kërkuar kompensim në emër të inflacion. Ku periudha e kërkuar në emër të inflacionit është nga viti 2019 – 2022. Andaj, i kanë propozuar gjykatës që padinë dhe kërkesëpadinë ta aprovojë në tërësi si të bazuar

Shpenzimet procedurale i ka kërkuar.

E paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, në përgjigjen në padi, ka theksuar se gjykata mund të shqyrtoj një padi që ka elemente nga kontesti i marrëdhënies së punës vetëm nëse paditësit i kanë shtjerrur të gjitha mjetet në procedurë të rregullt pranë të paditurës si organ administrativ. Sa i përket Kontratës Kolektive të Arsimit të vitit 2021 MASHTI ka shkëputur këtë kontratë me SBASHK. MASHTI me këtë rast ka theksuar se shkëput kontratën njëanshëm bazuar në kornizën ligjore në fuqi, pasi e njëjta është nënshkruar në mungesë të bazës ligjore. Me rastin e lidhjes së kontratave kolektive në nenin 2 të dy kontratave janë deleguar kompetenca dhe detyrime për të paditurën pa u shoqëruar edhe me buxhet shtesë,

këto detyrime nuk janë zbatuar nga niveli qendror i pushtetit. Duke shtuar se kërkesa në kuptim të nenit 87 të Ligjit të Punës, është parashkruar. Andaj i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj tërësisht si të pa bazuar ndaj të paditurës Komuna Rahovecit.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Për të vërtetuar gjendjen faktike në mënyrë të plotë dhe të drejtë, gjykata ka bërë administrimin e këtyre provave: kontratën e punës për mësimdhënës-paditësit, e lidhur ndërmjet Komunes së Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe Listën e pagave të muajit dhjetor 2022.

Gjykata pasi që bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 8, 398 dhe 399 të LPK-së, arriti në përfundim se në këtë çështje juridiko- civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që:

Nuk ishte kontestues fakti se paditësit kishin të themeluar marrëdhënien e punës me kontratë tek e paditura. Në këtë çështje juridike kontestues mbetet fakti se a i takon paditësve kompensimi nga marrëdhënia e punës me bazë për inflacion, a është kërkesa e parashkruar dhe a ka legjitimitet real pasiv e paditura.

Me administrimin e kontratës e punës për mësimdhënës-paditësit të datave të ndryshme, të lidhura ndërmjet Komunes së Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe paditësëve te lartecekur, gjykata vërtetoi faktin se paditësit kan kontratë pune me të paditurën dhe te njëjtit janë të sistemuar në vendin dhe me detyrat e punës në SH.M.L “Xhelal Hajda-Toni” në Rahovec, Komuna e Rahovecit, po ashtu të gjithë paditësit janë në listën e pagave të muajit dhjetor 2022, dhe u vertetua se paga baze eshte 459.00 euro.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë duhet të zbatohen edhe dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017 dhe asaj të datës 22.01.2021, ku në nenin 35 par.10 parashihet se “Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë”, si dhe duke u bazuar edhe në mendimin juridik të gjykatës Supreme të Kosovës nr.214/2023 date 09.10.2023 ku në pikën II parashihet që “Punëtorët në bazë të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021, kanë të drejtë që në pagën e tyre të futet përqindja e inflacionit marrë për bazë shkallën e inflacionit çdo vit, sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës, ashtu siç është përcaktuar me nenin 35, pika 10 të këtyre marrëveshjeve”. Andaj, gjykata vendosi si në pikën nën II. të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke e detyruar të paditurën që paditësve secilit veq e veq i takon e drejta në pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, si në pikën nën II. të dispozitivit të këtij aktgjykimi per periudhen kohore nga data 01.06.2019 e deri 21.11.2022.

Gjykata vendosi ta refuzojë pjesërisht si të pabazuar kërkesëpadinë, mbi bazen se kemi te bejme me parashkrim të kërkesës në emër të inflacionit që përfshin periudhe kohore prej datës 01.01.2019 deri me datës 30.05.2019. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate baza juridike e parashkrimit të kërkesave në të holla në kontestet e marrëdhënies së punës është në nenin 87 të Ligjit të Punës, sipas të cilit “Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”. Prandaj edhe kërkesa për kompensim në emër të inflacionit për këtë periudhë kohore 01.01.2019 e deri 30.05.2019, është

parashkruar pasi që padia është parashtruar me datë 16.05.2022, dhe bazuar ne faktin se 3 vite mbrapa nga data e paraqitjes se padise arrihen me daten 16.05.2019, Andaj para kesaj date gjykata vlerson se kemi te bejme me parashkrim te kerkeses, andaj edhe vendosi qe te njejten ta refuzoj mbi bazen e parashkrimit.

Nga të lartcekurat, gjykata me rastin e vendosjes që ta aprovojë pjesërisht kërkesëpadinë e paditëseve jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 398 të LPK-së, ku është përcaktuar se “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë.” Në këtë drejtim, gjykata nga shkresat e lëndës vërtetoi gjendjen faktike, pra faktin se paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura dhe kërkesëpadinë e tyre e aprovoi pjesërisht pasi që është e bazuar në Kontratës Kolektive të Arsimit e Kosovës.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale gjykata e mori në kuptim të nenit 452.2 të LPK-së, i cili përcakton se: “Po që se paditësi vetëm pjesërisht ka sukses në procesin gjyqësor, atëherë gjykata mundet, duke marrë parasysh suksesin e arritur, të caktojë që secila palë t’i bartë shpenzimet e veta apo që njëra palë t’ia shpërblej tjetrës, dhe ndërhyrësit që i është bashkuar, pjesën proporcionale të shpenzimeve”, në kuptim të kompensimit të shpenzimeve të palës gjyqësore, duke vendosur që paditësja t’ia kompensojë të paditurit shumën si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, në shumën e përgjithshme prej 665.00 euro, dhe atë për përpilimin e padisë 312.00 euro, për përpilimin e precizimit të padisë 312.00 euro si dhe për taksën gjyqësore 41.00 euro.

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC,
C.nr.298/2022, më 05.07.2024**

**Gjyqtari
Betim Behluli**

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditëve, nga dita e pranimi të këtij aktgjykimi, ankesa paraqitet nëpërmjet të kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit, Divizioni Civil në Prishtinë.